



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1087/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Albert Haxhaj kandidat për asamblenë komunale në Klinë nga Iniciativa Qytetare Klinë dhe ankesën e Blerta Maliqaj kandidate për asamblenë e komunale në Klinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si të bazuara ankesat e Anr.1087/2013 e datës 03.12.2013 e parashtruar nga Albert Haxhaj, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë nga radhët e Iniciativës Qytetare Klinë, dhe ankesa Anr.1132/2013 e datës 03.12.2013 e parashtruar nga Blerta Maliqaj kandidate për anëtarë të kuvendit komunal në Klinë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës.

URDHËROHET, KQZ-ja që të rinumëroj fletëvotimet në Qendrën e Votimit (QV) 0808c, vetëm sa ju përket kandidatëve të sipërshtuar dhe ky numërim, rezultati të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i, më datën 03.12.2013 ka pranuar ankesat me nr. Anr. 1087 nga Albert Haxhaj Kandidat për asamblenë komunale në Klinë nga Iniciativa Qytetare Klinë (IQK) dhe Blerta Maliqaj kandidate për asamble komunale në Klinë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur keqpërdorime dhe manipulime të votave.

- Në ankesën Anr.1087 të datës 03.12.2013, në të cilën kandidati për asamble komunale në Klinë nga IQK, pretendon se në VV me nr.0808c-02R i mungojnë 68 vota të rregullta. Sipas parashtruesit të ankesë në këtë VV, IQK me nr të listës 86 ka pasur 88 vota dhe prej tyre 68 vota kanë qenë të tijat dhe nr i tij për asamble komunale është 11 dhe votat nuk janë bartur në FRK. Po ashtu pretenduesi i ankesës thekson se në KQZ janë publikuar 87 vota dhe është renditur i 6(gjashti), ku në këtë rezultat më mungojnë 68 vota.

- Në ankesën Anr.1132 të datës 03.12.2013, në të cilën kandidatja për asamble komunale në Klinë pretendon se më datën 03.11.2013, pas numërimit të votave në Qendrën e Votimit 0808c përkatësisht në shkollën fillore “Dëshmorët e Qëndresës” se në rezultatin e kumtuar ka fituar 53 vota nga 4 (katër) vendvotime si vijon;0808c/01R katër (4) vota, 0808c/02R njëzet e shtatë (27) vota,0808/03R trembëdhjetë (13) vota,0808/04R tetë (8) vota dhe nga rezultatet e QNR-KQZ del se në qendrën në fjalë ka vetëm dyzet e tetë (48) vota .

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërsënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat tjera të lëndës e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

- **ankesat janë të bazuara**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga palët ankuese si dhe nga hetimi i bërë në QNR ka vërejtur se ka pasur parregullsi pasi që gjatë hetimit të bërë në QNR ka vërtetuar se ka mos përputhje të thella në mes FPR-ve dhe FRK-ve për këtë Qendër të Votimit 0808c. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 1087/2013 më datën 06.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

